

LIGJ
Nr.10 140, datë 15.5.2009

**PËR FINANCIMIN NGA BUXHETI I SHTETIT TË BASHKËSIVË FETARE, QË KANË
NËNSHKRUAR MARRËVESHJE ME KËSHILLIN E MINISTRAVE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

1. Shteti mbështet financiarisht bashkësitë fetare, Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Kishën Katolike në Shqipëri dhe Kryegjyshatën Botërore Bektashiane, të cilat kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave.

2. Me “bashkësi fetare”, sipas këtij ligji, kuptohen vetëm ato bashkësi që kanë lidhur marrëveshje me Këshillin e Ministrave.

Neni 2

1. Shteti mund të financojë pjesërisht bashkësitë fetare për ndërtimin, mirëmbajtjen e objekteve të kultit, si edhe në ringritjen e restaurimin e qendrave të pelegrinazhit e të infrastrukturës së tyre ndihmëse, për objektet që lidhen me turizmin fetar, sipas projekteve, që paraqiten nga bashkësitë fetare te Komiteti Shtetëror për Kultet dhe miratohen nga ministri përgjegjës për kultet.

2. Përcaktimi i masës së financimit bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 3

Shteti financo bashkësitë fetare deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore, për punonjës të personelit të administratës, sipas listëpagesave të paraqitura në institutin përkatës të sigurimeve shoqërore.

Neni 4

1. Shteti financo bashkësitë fetare për pagat e arsimtarëve të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar, që zotërohen drejtpërdrejt ose përmes organizatave jofitimprurëse, të krijuara e të administruara nga bashkësitë fetare dhe që janë të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe/ose nga Këshilli i Ministrave.

2. Përcaktimi i masës së financimit dhe procedurat për shpërndarjen e tyre bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave, në bazë të projekteve të paraqitura në Komitetin Shtetëror për Kultet dhe të miratuara nga ministri përgjegjës për kultet.

3. Duke mbajtur parasysh rrethanat dhe nevojat konkrete, shteti mund t’i japë objekte ose ndërtesa, në përdorim ose me qira, një bashkësie fetare, për plotësimin e nevojave në fushën e arsimit.

Neni 5

1. Kryegjyshata Botërore Bektashiane, për shkak të pozitës së veçantë si kryegjyshitë botërore, me qendër në Tiranë dhe të shtrirjes së veprimtarisë së saj jashtë vendit, përfiton një fond vjetor, i cili përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në bazë të projekteve të paraqitura.

2. Kryegjyshata Botërore Bektashiane ia paraqet projektet Komitetit Shtetëror për Kultet, i cili, nëpërmjet ministrit përgjegjës për kultet, ia propozon Këshillit të Ministrave.

Neni 6

Fondet për mbështetjen financiare dhe shpërndarja e këtyre fondeve shtetërore, sipas parashikimeve të bëra në nenet 2, 3 e 7 të këtij ligji, sipas nevojave dhe kërkesave të secilës bashkësi fetare, miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për kultet.

Neni 7

1. Komiteti Shtetëror për Kultet harton formularët e nevojshëm për aplikim për fonde dhe ua shpërndan bashkësive përkatëse. Formularët miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për kultet.

2. Mbështetja financiare dhe shpërndarja e fondeve shtetërore kryhen vetëm pasi të jetë paraqitur kërkesa për aplikim dhe duke mbajtur parasysh këtë kërkesë.

3. Bashkësitë fetare i dorëzojnë kërkesat e tyre brenda afatit të përcaktuar në ligjin vjetor për Buxhetin e Shtetit.

Neni 8

Përdorimi i fondeve shtetërore, që u jepen bashkësive fetare, auditohet nga institucionet përkatëse shtetërore, të ngarkuara me auditim, në bazë të legjislacionit në fuqi.

Neni 9

Kur vërehet shpërdorimi i fondeve shtetërore nga ndonjë bashkësi fetare, organet përkatëse shtetërore të ngarkuara veprojnë dhe marrin masa, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 10

Për planifikimin, ndjekjen dhe mënyrën e përdorimit të fondeve shtetërore, sipas këtij ligji, ngarkohen Komiteti Shtetëror për Kultet, ministri përgjegjës për kultet dhe institucionet e tjera përgjegjëse, që kanë lidhje ose ngarkohen me ndjekjen dhe kontrollin e fondeve shtetërore.

Neni 11

Personat fizikë dhe juridikë, që sponsorizojnë bashkësitë fetare, përfitojnë për shumën e sponsorizuar lehtësi tatimore, sipas nenit 5 të ligjit nr.7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, të ndryshuar.

Neni 12

Dispozita kalimtare dhe të fundit

Për legalizimin e objekteve të kultit, të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar, objekteve me destinacion për shërbime sociale a shëndetësore, bashkësitë fetare përjashtohen nga pagesat, që rrjedhin nga zbatimi i ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

Neni 13

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 2 pika 2, 4 pika 2, 5 e 6 të këtij ligji.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6198, datë 5.6.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**